

I. Sfond.

Subjekti "METEO" sh.p.k. është subjekt vendas, i regjistruar në Q.K.B. me datë 10.01.2012 me NIPT L26310801C dhe, adresë të aktivitetit Fshati Çekin, Njësia Administrative Pishaj, Gramsh, Elbasan.

Vendi ku ushtrohet ky aktivitet është në kufirin jug-lindor të teritorit të fshatit Çekin, në afërsi të rrugës automobilistike kombëtare Elbasan – Gramsh.

Objekti i aktivitetit të këtij subjekti është, në fushën e ndërtimit, në fushën e transportit të mallrave dhe udhëtareve, brenda dhe jashtë vendit, në fushën e tregëtisë me shumicë dhe pakicë të mallrave ushqimore, industrialë, të automjeteve e tregëti të tjera të lejuara nga ligji. Tregtim i karburanteve të ndryshëm, gazit të lëngëshëm. Në fushën e shfrytëzimit të pyjeve, përpunim të lëndë të drurit etj.

Administrator i shoqërisë është z. Erind Bengu, për periudhën 25.09.2017 deri 25.09.2022

Subjekti "METEO" sh.p.k. është i pajisur me :

- i. Leje Mjedishi PN-2978-06-2016, Kodi III.1.A "Stacion transferimi për mbetje jo të rrezikëshme".

II. Qëllimit të projektit të propozuar.

Projekti i zbatuar prej më shumë se 5 vitesh, përfshin linjën teknologjike të prodhimit të markave të ndryshme betoni të këtij subjekti. Prodhimi i betonit të markave të ndryshme, në këtë linjë teknologjike bëhet nëpërmjet pajisje të specializuar të cilat punojnë në mënyrë të automatizuar, në bazë të programit të instaluar në pultin e komandimit. Proçesi i ngarkimit të agregatit dhe çimetos në silozët dhe bunkerët përkatës bëhet me anë të një mjeti ngarkimi, me kovë 0.5 m³.

III. Planimetria e vendndodhjes së projektit ku të pasqyrohen në hartë topografike sipërfaqja e tokës së kërkuar, kufijtë e sipërfaqes së tokës së kërkuar, fotografi dhe të dhëna për përdorimin ekzistues të sipërfaqes së tokës që do të përdoret përkohësisht apo përherë nga projekti gjatë fazës së ndërtimit apo funksionimit të veprimtarisë së projektit.

Vendndodhja e linjës teknologjike të prodhimit të betonit në hartën topografike me shkallë 1:25000 dhe, bën pjesë në planshetën i përfshirë brenda koordinatave të pasqyruara në tabelën e mëposhtme:



Tabela me koordinatat e kulmeve te lejes minerare te shfrytezimit.

Nr. i pikës	Y	X
1	44 29 656	45 29 185
2	44 29 747	45 29 240
3	44 29 774	45 29 171
4	44 29 664	45 29 124

Brenda këtyre koordinatave përfshihet një sipërfaqe prej 2140 m².

Trualli mbi të cilën zhvillohet kjo veprimtari nuk ka asnjë lloj funksioni apo përdorimi veç atij në shërbim të kësaj veprimtarije. Ai karakterizohet nga një sipërfaqe pothuajse e çveshur nga bimësia. Në të, nuk ka asnjë element infrastrukture, kjo edhe për faktin se është larg qendrës së banuar, mungesës së burimeve ujore, është jashtë planeve të pushtetit për ndërtimin e infrastrukturës dhe elementëve të saj.

Objekti gjendet rreth 100 metra larg nga rruga kombëtare Elbasan – Gramsh. Kjo rrugë u shërben edhe banorëve të zonës për lëvizjen e tyre si dhe të produkteve bujqësore. Në perëndim të kësaj rruge, gjendet bregu i Devollit, në një distancë ajrore prej rreth 140 m, nga konturi i objektit.

IV. Informacioni për qendrat e banuara në zonën ku propozohet të zbatohet projekti, shoqëruar me fotografi dhe të dhëna për distancën nga vendi ku propozohet projekti e për njësinë e qeverisjes vendore (bashkia/komuna) që administron territorin ku propozohet projekti.

Objekti ku zhvillohet veprimtaria që ne përshkruajmë, gjendet në territorin e Fshatit Çekin, të Njësisë Administrative Pishaj, të Bashkisë Gramsh. Pishaj bën pjesë në një krahinë malore me një relief kryesisht të thyer kodrinor - malor, me një lartësi mesatare prej rreth 750 m mbi nivelin e detit. Zona e Pishajt, përfshihet në zonën klimatike mesdhetare kodrinore dhe në zonën klimatike mesdhetare malore nënzona juglindore pjesa e sipërme e relievit që shtrihet deri në lartësinë 600-1000 m mbi nivelin e detit. Kushtet klimatike janë të përshtatshme në përgjithësi për zhvillimin bujqësor dhe blektorial. Prania e llojeve të ndryshme të tokave si dhe kushtet klimaterike, kanë kushtëzuar edhe zhvillimin e bimësisë, si atë natyrore dhe atë të kultivuar.

Veshja bimore, kushtet klimatike, si dhe karakteristikat e tokave, vlerësohen relativisht të përshtatshme për zhvillimin e një faune të pasur të kësaj zone dhe atë të Gramshit.

Familjet fshatare kanë në pronësi një sasi relativisht të vogël tokë arë rreth 1.25 ha, sasi kjo e pamjaftueshme për zhvillimin e një ekonomie bujqësore me kërkesat e ekonomisë së tregut. Ndër kulturat e drithërave gruri zë peshën specifike më të madhe, rreth 35 % të sipërfaqes së mbjellë me bimë arësh. Me misër mbillet rreth 21 % e sipërfaqes që zënë drithërat e bukës. Pesha specifike e misrit për prodhim buke po vjen duke rënë çdo vit. Ai më gjërë përdoret si ushqim për blegtorinë.

Kushtet klimatike favorizojnë kultivimin e një numëri të konsiderueshëm llojesh perimesh, si patatja, fasulja, domatja, qepa, kastravec, speci, hudhra, kungulli, lakra, e deri te erëzat e ndryshme. Zona ka tradita edhe në pemëtari e vreshtari. Kështu përmendim kultivimin e rrushit, mollës, dardhat, kumbullat, arrat, gështenjat, ullirin, etj.

Kushtet natyrore të relievit krijojnë mundësi për mbarështimin e blegtorisë, veçanërisht të deles e të dhisë, por edhe të gjedhit e të një thundrakëve. Këtu rriten edhe mjaft shpendë të butë kryesisht pulat dhe gjeli i detit.

Njësinë Administrative Pishaj, përfshin brenda territorit të saj fshatrat Pishaj, Trashovicë, Koçaj, Gramsh, Vinë, Tërvol, Shmërizë, Gurëz, Ostrenth, Qerret, Çekin, Stror, Liras, Galigat, Cingar i Sipërm, Cingar i Poshtëm, Drizë, Gjergjevinë, Kotorr dhe Cërunj, me një popullsi prej rreth 6500 banorë.

Në afërsi të këtij objekti nuk gjenden godina banimi apo të shërbimeve tregtare, shkolla etj. në lindje të objektit në një distancë ajrore prej rreth 150 metra gjendet kufiri administrative i uzinës së Çekinit.

V. Skicat dhe planimetritë e objekteve të projektit dhe strukturave të projektit.

Bashkangjitur janë dhënë disa prej fletëve më kryesore të projekteve të zbatuara në këtë veprimtari nga fillimi i saj në vitin 2012 deri në ditët e sotme.

VI. Përshkrimi i proceseve ndërtimore dhe teknologjike, përfshirë kapacitetet prodhuese/përpunuese, sasi të lëndëve të para dhe produktet përfundimtare të projektit.

i. Përshkrimi i proceseve ndërtimore.

Veprimtaria e këtij subjekti ka nisur që Janar 2012, kur është bërë rregjistrimi në organin tatimor. Mbështetur në projektet ndërtimore dhe në ato të instalimit të makinerive dhe pajisjeve, janë kryer punimet përkatëse për ndërtimin e shesheve të punës, bazamenteve ku janë instaluar makinerinë dhe pajisjet e linjës teknologjike si dhe janë ndërtuar rrjetet inxhinjerie, të furnizimit me energji elektrike, furnizimit me ujë, rrjetit të mbledhjes dhe shkarkimit të ujrave sipërfaqësore dhe të ujrave të zeza etj.

Në momentin aktual, nuk kryhet asnjë lloj investimi në fushën e ndërtimit dhe të instalimit të makinerive apo linjave të reja. Gjithashtu nuk ka plane afat shkurtëra të zhvillimeve të reja, për këtë subjekt.

ii. Përshkrimi i procesit teknologjike.


Subjekti "METEO." sh.p.k. për një periudhë kohe relativisht të gjatë ushtron aktivitetin në veprimtarinë e prodhimit të betonit. Fabrika apo linja teknologjike e prodhimit të betonit është vënë në shfrytëzim në zbatim të projekteve përkatëse në të cilët janë përcaktuar të gjitha detajet e shfrytëzimit, duke filluar nga lloji i lëndëve të para dhe të atyre ndihmëse që përdoren për prodhimin e betoneve, të sheshet e punës, numurin e fuqisë puntore, kohën e punës, ditët e punës në muaj dhe në vit në përputhje me kapacitete prodhuese mujore e vjetore.

Linja e prodhimit të betonit përbëhet nga :

- Pulti i komandimit.
- Silloz çimentoje me vëllim 45 m^3 .
- Silloz çimentoje me vëllim 45 m^3 .
- Bunkeri i inerteve me vëllim 100 m^3
- Peshore e çimentos dhe e inerteve.
- Transportjeri i inerteve

Me termin beton në rastin e përgjithshëm shënohen materialet ndërtimore të përbëra nga agregati / mbushësit (rëra me zhavorrin ose çakalli), mjetit lidhës dhe ujit dhe në disa raste të caktuara dhe shtesa speciale - aditivë.

Prodhimi i betonit është një operacion pune i njohur dhe relativisht i thjeshtë sepse ka të bëjë me përzjerjen e tre elementëve përbër të tij që janë inertet, çimentoja dhe uji.



Në raste të veçanta, mund të përdoren edhe shtesa për përmirësimin e cilësisë së kërkuar të një marke betoni.

Vetit apo treguesit cilësor të betonit varen dhe përcaktohen nga të gjithë lëndët përbërëse të tij, nga lloji dhe sasia si dhe, treguesit cilësor të tyre. Po kështu treguesit cilësor të betonit janë të kondicionuar edhe nga kushtet e transportit, vendosja-shtruarja si dhe kujdesi për betonin.

Në varësi nga masa vëllimore / kubike e realizuar, betoni ndahet në:

- ❖ **betone të lehta** - me masë vëllimore më të vogël se 1800 kg/m^3 ;
- ❖ **betone të thjeshta (normale)** – me masë vëllimore $1800 - 2500 \text{ kg/m}^3$;
- ❖ **betonet e rënda** - me masë vëllimore më të madhe se 2500 kg/m^3 ;

Kjo linjë teknologjike prodhon kryesisht betone të thjeshta – normale të cilët paraqesin një nga materialet themelore të ndërtimit dhe kanë zbatim më të madh në praktikën e përditëshme. Për prodhimin e këtij lloji betoni, si lëndë lidhëse shfrytëzohet çimento, si agregat mbushës – inerte të nxjerra nga shtrati i lumit ose inerte të gurit si dhe uji.

Betoni si material ndërtimor veçohet me qëndrueshmëri të lartë ndaj shtypjes dhe qëndrueshmëri të vogël ndaj tërheqjes. Për shkak të këtyre vetive ai, mund të përdoret për realizimin e konstruksioneve në të cilat mbizotërojnë tensionet apo forcat në shtypje siç janë: themele, disa lloje të mureve mbështetëse dhe shtylla, blloqe për muratim etj.

Në elementet ndërtimore në të cilët paraqiten apo mbizotërojnë edhe tensionet apo forcat në tërheqje që janë edhe rastet më të shpeshtë në praktikë, në këto element ndërtimore vendosen shufra prej çeliku (armaturë). Kështu, elementet ndërtimore prej betonit të

përforuara/armuara mund të pranojnë/durojnë ngarkesa dhjetë herë më të mëdha. Materiali i cili fitohet me gërshetim të betonit dhe armaturës metalike quhet **beton i armuar** dhe prej tij mund të realizohen konstruksione të objekteve nga ndërtimi i lartë, objekte hidroteknike, ura, tunele, silose etj.

Linja teknologjike e prodhimit të betonit, vihet në punë sa herë që ka kërkesa për betone të markave të ndryshme. Eksperienca e punës në shfrytëzimin e saj ka tregu se linja ka punuar mesatarisht gjatë 185 ditëve dhe ka arritur të prodhojë rreth 2100 m³ beton gjatë një viti kalendarik.

Është një linjë e cili punon tërësisht e automatizuar, në bazë të programeve të instaluar në panelin/pultin e tij të komandimit.

Granili me një përbërje granulometrike të caktuar (raporti sasior i përmbajtjes së madhësive të caktuara kokrrizash të lëndës inerte) është i vendosur në depozitën përkatëse të impjantit. Po kështu edhe çimentoja e një marke të caktuar është vendosur në sillozët përkatës.

Nëpërmjet pultit të komandimit përcaktohen sasitë respektive të inertit, çimentos dhe uji të cilët dërgohen në përzjerësin mekanik të tyre. Këtu bëhet përzjerja homogjenizuese e të tre këtyre lëndëve për disa minuta dhe pas kësaj, ngarkesa e pregatitur shkon në makinën transportues, e cila gjatë lëvizjes për në destinacion vijon të përzjehë betonin e pregatitur.

iii. Ngarkimi dhe transporti i brendëshëm.

Ngarkimi dhe transporti i brendëshëm në këtë veprimtari janë dy prej proceseve teknologjike kryesorë. Këtyre dy proceseve ju nënshtrohen të gjitha llojet e lëndëve/materialeve të cilat përdoren si lëndë e parë të tilla si inertet, çimentoja etj. dhe njëkohësisht edhe prodhimet e kësaj veprimtarie si betoni etj.

Lëndët e para sillen në objekt kryesisht me mjete transporti, të subjekteve të liçensuar për prodhimin dhe transportin e inerteve, çimentos etj.

Transporti i betonit nga linja e prodhimit të tij, në vendin ku ai do të përdoret kryhet me automjet të specializuar për këtë qëllim. Ngarkimi i automjetit bëhet në mënyrë të drejtpërdrejtë nga linja teknologjike e prodhimit të betonit.

Brenda teritorit të objektit gjendet edhe një shesh i sistemuar i cili shërben për parkimin e mjeteve që punojnë në këtë veprimtari.

iv. Lëndët e para dhe ato ndihmëse.

- *Agregati / mbushësit (rëra me zhavorrin ose çakalli),*


Agregati është komponenti më i përfaqësuar në masën e përgjithshme të betonit (70-80%). Sipas vetive fizike dhe kimike të tij ai nuk është material inert për arsye se ka ndikim në vetitë fiziko-kimike të betonit. Për përgatitjen e betonit shfrytëzohet agregat me prejardhje të ndryshme – natyrore dhe artificiale, siç janë:

- **Agregat natyror** (rërë, çakall dhe grimca / kokrra).

Agregati natyror – rërë dhe çakall nxirret nga shtretërit e lumenjve dhe përrenjve afër brigjeve të tyre. Kokrrat e këtij agregati natyror janë kryesisht të rrumbullakuara si pasojë e transportit më shpesh bashkë me ujin dhe erozionit, që ndikon në mënyrë të volitshme në përpunueshmërinë dhe vendosshmërinë e betonit.

- **Agregat i grimcuar ose i bluar**, i fituar me grimcim të shkëmbinjve gëlqeror monolit ose të palidhur.

Agregati i grimcuar, fitohet me grimcimin e shkëmbinjve natyror të fortë prej cilësdo prejardhje. Kokrrat e agregatit të grimcuar janë me tehet të mprehta çka mundëson inkastrim të tyre më të mirë dhe kjo kontribuon për përmirësimin e disa karakteristikave mekanike të betonit. Vetë e volitshme e agregatit të grimcuar është edhe homogjeniteti petrografik i tij ç'ka kontribuon që t'i shmanget ose zvogëlohet koncentrimi i sforcimeve në beton nga veprimi i ngarkesave ose ndryshimeve të temperaturave.



rërë, çakall dhe grimca / kokrra



agregat i grimcuar i shkëmbinjve gëlqeror

- **Agregat artificial** i fituar nga materiale të mbetura të ndryshme dhe prodhime –anësore industriale (mbeturina nga hiri i teceve, skorjet metalurgjike, materiale vullkanike etj.);
- **Agregate speciale**, siç janë: kermaziti, perliti i ekspanduar, materiale me fije të ndryshme etj.

Mes vetive fizike-mekanike më të rëndësishme ndaj të cilave duhet të kemi kujdes për çdo njerin prej llojeve të agregatit janë:

- Forma dhe pamja e sipërfaqes të kokrrizës së agregatit,
- Përmbajtja e grimcave të imëta në agregat,
- Përmbajtja e grimcave të lehta në agregat,
- Mbështjellja e sipërfaqes të kokrrave të agregatit,
- Përmbajtja e materieve organike në agregat,
- Prania e silicit amorf në agregat,

- Masa vëllimore e agregatit,
- Qëndrueshmëria e agregatit,
- Përbërja granulometrike e agregatit etj

Për arsye se për përgatitjen e betonit më shpesh shfrytëzohen kokrra kompakte, lagështinë e agregatit në masë më të madhe e përbën uji, i cila mbahet/gjendet në sipërfaqen e kokrrave. Lagështia sipërfaqësore, në varësi nga sipërfaqja specifike e agregatit mund të lëvizë deri 10 %. Lagështia e agregatit duhet të përcaktohet para përdorimit të tij, për shkak të përcaktimit të sasisë të ujit që duhet t'i shtohet gjatë përgatitjes së betonit.

○ *Lëndët lidhëse.*

Mjetet lidhëse kanë për detyrë t'i lidhin pjesët nga agregati në një komponent të tërësishëm. Si mjet lidhës mund të shfrytëzohen të gjitha llojet e çimentos, gëlqeres ndërtimore, gipsit, asfaltit, lloje të ndryshme të polimerive e tjera.

Çimentoja është mjet lidhës hidraulik i cili në kombinim me ujin transformohet në brumë të çimentos, i cili gjatë kohës ngurtësohet. Në varësi nga përbërja dhe mënyra e përpunimit ekzistojnë më shumë lloje të çimentos, por më së tepërmi përdoret i ashtuquajtimi **portland-çimento**.

Çimentot grupohen në klasa të cilat shënohen me numrat 25, 35S, 35B, 45S, 45B dhe 55 ku janë:

- S – çimento me rritje më të ngadalësuar të qëndrueshmërisë.
- B – çimento me rritje më të shpejtë të qëndrueshmërisë.

Me përzierjen e portland-çimentos dhe ujit fitohet brumë prej çimentos–pastë e cila gradualisht fillon të lidhet dhe ngurtësohet gjatë një periudhe kohe të caktuar, çka e ndryshon gjendjen e vetë agregate, duke kaluar nga një lëndë plastike në lëndë të ngurtë. Shkaqet për ndodhjen e këtyre ndryshime janë proceset shumë të ndërlikuara fizike – kimike që zhvillohen në marëdhënien e çimentos me ujin, e njohur si **hidratim të çimentos**.

Proçesi i hidratimit fillon disa minuta pas përzierjes të çimentos dhe ujit dhe në etapën e parë e cila zgjatë rreth 5 deri 10 orë, brumi i çimentos gradualisht ngurtësohet – lidhet dhe pastaj krijohet ngurtësimi gradual. Studime të ndryshme teorike dhe praktike kanë treguar se për hidratimin e tërësishëm të çimentos është i nevojshëm sasi e saktë ujit, përcaktuar në vartësi nga lloji dhe përbërja e çimentos.

Shpejtësia e hidratimit varet nga një numër i madh i faktorëve, të tillë si:

- përbërja minerale e çimentos,
- cilësia e bluarjes të çimentos,
- sasia e ujit,
- temperatura e rrethinës/ambientit rrethues,
- etj.

○ Uji.

Uji në formën e tij të pastër, është lëng pa shije dhe pa erë po ashtu dhe pa ngjyrë. Duket i pangjyrë në sasi të vogla për syrin tonë, megjithëkëtë mund të shihet si i kaltër në sasi të mëdha ose me vegla shkencore. Uji është lëngu më i përhapur në tokë. Formula kimike e tij është H_2O . Uji është në ekuilibër dinamik midis gjendjes së gaztë dhe asaj të lëngët në temperaturë dhe trysni standarde. Uji në vetvete është pa shije dhe pa ngjyrë por në kontakt të gjatë me ajrin lidhet me dioksidin e karbonit (CO_2) dhe merr një shije të athët acidi karbonik që nuk është i mirë për shëndetin. Ai është i domosdoshëm për të gjitha format e jetës dhe njihet edhe si tretësi më i gjithanshëm. Pa të, jeta siç e njohim ne, do të ishte e pamundur.

Uji është një tretës shumë i mirë dhe tret shumë lloje substancash. Ndryshe mund të quhet tretës universal. Substancat që treten mirë në ujë quhen hidrofiliqe ndërsa, ato që nuk treten mirë në ujë, quhet hidrofobike. Uji është tretësi më i mirë (universal) falë strukturës së molekulës së tij që është dipolare.

Uji i përshtatshëm për t'u pirë nga njeriu quhet ujë i pijshëm. Uji që nuk është i përshtatshëm për t'u pirë, por që nuk është i rrezikshëm për njerëzit quhet ujë i sigurt.

○ *Shtesa speciale - aditivë.*

Aditivët paraqesin shtesa të veçanta me të cilat mund të përmirësohen disa veti të betonit të freskët dhe të ngurtësuar siç janë përpunueshmëria, vendosshmëria-shtruarja e betonit, pa depërtueshmëria e ujit etj.

- VII. Informacioni për infrastrukturën e nevojshme për lidhjen me rrjetin elektrik, furnizimin me ujë, shkarkimet e ujërave të ndotura dhe mbetjeve, si dhe informacion për rrugët ekzistuese të aksesit apo nevojën për hapje të rrugëve të reja.

Objekti ku zhvillohet veprimtaria e prodhimit të betonit, është i lidhur me rrjetet inxhinjrike të fshatit Çekin. Për kryerjen normale të kësaj veprimtarije është e nevojshme përdorimi i energjive të përshkuara në vijim:

a. Energji elektrike.

Energjia elektrike e nevojshme merret nga rrjeti i furnizimit me energjie elektrike të zonës, në bazë të kontratës përkatës me OSSHE e kësaj zone. Brenda objektit është ndërtuar rrjeti shpërndarës që dërgon rrymën elektrike në të gjitha pikat konsumatore të saj. Energjia elektrike përdoret kryesisht për ndriçimin e ambjenteve të punës, rrugëve etj. Energjia elektrike e harxhuar mesatarisht në një muaj është rreth 386 kWh.

b. Furnizimi me ujë.

Uji është pjesmarrës në proceset teknologjike që zhvillohen në këtë veprimtari, kryesisht për përgatitjen e betonit. Ai përdoret njëkohësisht edhe për plotësimin e nevojave humane, pastrimin e ambjentve të punës etj. Konsumi mesatar i ujit është rreth 105 m³/muaj. Për të siguruar mosndërprerjen e furnizimit me ujë, gjatë kohës që punon linja e prodhimit të betonit, është instaluar një depozitë uji me kapacitet 1500 litra.

c. Përdorimi lëndës djegëse, naftë.

Të gjitha mjetet që punojnë në këtë karrierë punojnë me lëndë djegëse naftë. Ajo blihet në subjekte të liçensuar për magazinimin dhe tretimin e saj. Konsumi naftës shkon mesatarisht në rreth 350 litra/muaj.

d. Shkarkimet e ujërave të ndotura.

Në objekt është ndërtuar një rrjet pusetash dhe kanalizimesh (tubash) nëntokësore për mbledhjen dhe shkarkimin e ujërave të ndotura. Këtu kemi, shkarkime të ujërave sipërfaqësore gjatë reshjeve të shiut si dhe shkarkime të rastësishme të ujërave gjatë proceseve të ndryshme pune. Këto ujra mbartin me vete grimca të ngurta të inerteve si dhe çimento. “Ndotja” e ujërave sipërfaqësore mund të ndodhë nga :

- Pastrimi i ambjentit ku është instaluar impjanti i prodhimit të betonit, në rastet e shkarkimit të materialeve që përpunohen aty, nga avari të ndryshme teknike,
- Ujrat e përdorura për qëllime sanitare.

Ujrat derdhen në një vaskë dekantuese dhe më tej në ujrat e lumit, i cili rrjedh disa metra larg kufirit jugor të objektit.

Në rrjetin e kanalizimeve shkarkohen vetëm ujrat që dalin nga ambjentet hidro-sanitare dhe që përmbajnësisht ujra të zeza. Ujrata e zeza derdhen në rrjetin e kanalizimeve të uzinës së Çekinit, i cili shkarkon drejtpërsëdrejti në ujrat e lumit Devoll .

e. Trajtimi i mbetjeve.

Zhvillimi i proceseve të prodhimit të betonit, krijon shkarkime të mbetjeve të ngurta të cilat përbëhen kryesisht prej inerteve, çimentos etj. Të gjitha këto lëndë **nuk klasifikohen** tek lëndë të rrezikëshme, sipas legjislacionit aktual të vendit tonë. Këto mbetje teknologjike qëndrojnë përkohësisht në vende të caktuara për to, deri në momentin e ripërdorimit në njerin prej proceseve teknologjike që zhvillon kjo veprimtari. Treguesit cilësor të lëndëve apo materialeve që përbëjnë mbetjet teknologjike, koha e kufizuar e qëndrimit të tyre në vendepozitimin e përkohëshëm, japin impakte minimale në tokë, në vendin e ku ato qëndrojnë.

Efekte të ndjeshme në treguesit cilësor të tokës jep keqadministrimi i përdorimit të vajrave, karburanteve, etj. Nëse ato derdhen në mënyrë të pakontrolluar në tokë gjatë punës së mjeteve apo furnizimit të tyre.

Në vijim po japin klasifikimin e mbetjeve të ngurta inerte që gjenerohen nga zhvillimi I kësaj veprimtarije, sipas V.K.M.-së Nr. 99, datë 18.02.2005 "PËR MIRATIMIN E KATALOGUT SHQIPTAR TË KLASIFIKIMIT TË MBETJEVE".

17 MBETJE NGA NDËRTIMET DHE PRISHJET (PËRFSHI DHERA TË GËRMUARA NGA ZONA TË KONTAMINUARA)

17 01 Beton, tulla, tjegulla dhe qeramika

17 01 01 Beton

17 02 Dru, qelqe dhe plastika

17 02 01 Dru

17 02 02 Qelqe

17 02 03 Plastikë

Në një vendin të caktuar, të shtruar me beton, janë vendosur kazanët e mbledheve të mbetjeve urbane të krijuar gjatë zhvillimit të kësaj veprimtarije. Këto mbetje largohen çdo ditë, nga ky vend duke u hedhur në kazanët e mbetjeve urbane të fshatit. Kështu që influenca e këtyre mbetjeve në cilësinë e tokës është minimale për të mos thënë që nuk egziston

f. Informacion për rrugët ekzistuese apo nevojën për hapje të rrugëve të reja.

Objekti në të cilën është instaluar linja teknologjike e prodhimit të betonit, është e lidhur me rrugët automobilistike të fshatit Çekin dhe të uzinës së armëve që gjendet në teritorin e këtij fshati. Lidhja me këtë rrugë automobilistike bën të mundur edhe lidhjen e objektit me rrugën automobilistike kombëtare Gramsh – Elbasan dhe nëpërmjet saj me rrjetin rrugor të vendit tonë.

Kjo lidhje rrugore është e mjaftueshme për të plotësuar kërkesat e kësaj veprimtarije për transport të lëndëve të para dhe të prodhimit të realizuar prej saj.

VIII. Programi për ndërtimin, kohëzgjatjen e ndërtimit, kohëzgjatjen e planifikuar të funksionimit të projektit, kohën e mundshme të përfundimit të funksionimit të projektit dhe, sipas rastit, edhe fazën e planifikuar të rehabilitimit të sipërfaqes pas mbarimit të funksionimit të projektit.

Në kohën e hartimit të këtij raporti teknik, në subjekt kanë përfunduar të gjitha punimet e ndërtimit dhe të instalimit të linjave teknologjike. Nuk ka programe afat shkurtëra për kryerje investimesh të reja.

IX. Mënyrat dhe metodat që do të përdoren për ndërtimin e objekteve të projektit.

Në përgjigje të kërkesave të kësaj rubrike, na duhet të përsëritim se tashmë kanë përfunduar të gjitha llojet e punimeve ndërtimore të planifikuara për ndërtimin dhe instalimin e pajisjeve të linjës teknologjike të prodhimit të betoneve.

Punimet e ndërtimit janë kryer nga vetë subjekti, si një subjekt që disponon lejet/liçencat përkatëse për të kryer të tilla punimesh.

X. Lëndët e para që do të përdoren për ndërtimin dhe mënyra e sigurimit të tyre (materiale ndërtimi, ujë dhe energji).

Lëndët e para të përdorura për ndërtim janë ato tradicionalet apo bazë në proceset ndërtimore në vendin tonë, betoni dhe hekuri. Betoni është pregatitur prej çakëlli të granular, çimentoje dhe uji duke përdorur shtesa të caktuar për betonet që janë përdorur për ndërtimin e bazamenteve mbi të cilat janë vendosur makineritë dhe pajisjet e linjës teknologjike. Këto lëndë të para, zotërohen nga vetë ky subjekt, në aktivitetet e tij ndërtimore, të përfshira në fushën e veprimtarisë së subjektit.

Duke qënë se, aktualisht dhe në prespektivën e afërt, nuk kemi zhvillim të asnjë lloj projekti ndërtimor, nuk mund të përshkruajmë lëndë të para dhe ndihmëse për zbatimin e të tillë projektesh.

XI. Informacioni për lidhjet e mundshme të projektit me projekte të tjera ekzistuese përreth/pranë zonës së projektit.

Projekti i zbatuar për ndërtimin dhe shfrytëzimin e linjës teknologjike të prodhimit të markave të ndryshme të betoneve që përdoren për ndërtimin e objekteve të ndryshme është i lidhur në mënyrë të drejtpërdrejtë me zhvillimet e veprimtarive të ndryshme në fushën e ndërtimit. Vetë subjekti METEO ka aktivitetet të caktuar në fushën e ndërtimit, arsye që ka çuar drejtuesit e tij, për kryerjen e investimit përkatës në ndërtimin dhe vënien në shfrytëzim të kësaj linje prodhimi betonesh.

Krahas shfrytëzimit të linjës për interesat e veta, kjo linjë prodhon betone të markave të caktuar edhe për subjekte të tjerë me aktivitetet në fushën e ndërtimit në këtë zonë.

XII. Informacioni për alternativat e marra në konsideratë për sa i takon përzgjedhjes së vendndodhjes së projektit dhe teknologjisë që do të përdoret.

Në rastin tonë konkret nuk mund të analizojmë alternativa të mundëshme për zgjedhjen e vendit të zhvillimit të veprimtarisë së prodhimit të betonit për arsye se investimi është kryer dhe linja teknologjike është në shfrytëzim prej disa vitesh. Gjithsesi si arsye thelbësore për zgjedhjen e vendit janë:

- i. Pronësia mbi truallin.
- ii. Mundësitë e lidhjes relativisht të lehtë me rrjetet inxhinjerike të zonës dhe me rrugët automobilistike
- iii. Egzistencës së kërkesave të vetë subjektit për prodhime betoni, në këtë zonë /rajon ku ai zhvillon aktivitetin e tij, të ndërtimit.

Lidhur me instalimin e teknologjisë së përdorur duhet të themi se është një teknologji e njohur dhe e zbatuar në shumë veprimtari të tilla.

Zbatimi në praktikë i proceseve teknologjike të përcaktuar në projektet përkatëse, kërkon një numur relativisht të kufizuar makinerish e pajisjes. Janë mjete standarte të cilat janë lehtësisht të manovrueshme dhe që mirëmbahen pa shumë probleme.

XIII. Të dhëna për përdorimin e lëndëve të para gjatë funksionimit, përfshirë sasi të ujit të nevojshëm, energjisë, lëndëve djegëse dhe mënyrën e sigurimit të tyre.

Lëndët e para për prodhimin e betoneve të markave të ndryshme janë të njohura dhe të përdorura nga subjekte të cilët kanë fushë të veprimtarië së tyre prodhimin e betonit.

Betoni përmban tre lëndë bazë, granilet/inertet, çimenton dhe uji.

Treguesit cilësor të sejcilës prej këtyre lëndëve si dhe raportet sasisore të përzjerjes së tyre, krijojnë betone me tregues cilësor të përcaktuar. Përdorimi i shtesave të caktuar përmirëson këto tregues cilësor.

Të dhënat përkatëse të literaturës së prodhimit të betoneve si dhe ato që rezultojnë nga eksperiencia e deritanishme e vetë subjektit, tregojnë për këto raporte sasiore mesatare të përbërësve të markave të zakonëshme betoni. Propocioni mesatar i çimentos : rërës : çakëllit (gurin e grimtuar) është 1.0 : 2.1: 4.2. Sasia e ujit është rreth 10 % e peshës totale të këtyre përbërësve, duke llogaritur këtu edhe sasinë e ujit sipërfaqësor që mbajnë inertet e përdorur. Për 1 m³ beton kemi rreth 270 kg çimento M400 + 597 kg rërë + 1210 kg zhavor + 215 litra ujë.

Granili/inertet lumore me një përbërje granulometrike të caktuar (raporti sasior i përmbajtjes së madhësive të caktuara kokrrizash të lëndës inerte) është komponenti më i përfaqësuar në masën e përgjithshme të betonit (75-80%). Sipas vetive fizike dhe kimike të tij ai nuk është material inert për arsye se ka ndikim në vetitë fiziko-kimike të betonit. Për përgatitjen e betonit shfrytëzohet agregat me prejardhje të ndryshme – natyrore dhe artificiale.

Duke ju referuar prodhimit mesatar vjetor prej rreth 2100 m³ beton gjatë një viti kalendarik, sasia e garanilitinerteve të përdorur shkon në 1570 – 1680 m³/vit.

Çimentoja është mjet lidhës hidraulik i cili në kombinim me ujin transformohet në brumë të çimentos, i cili gjatë kohës ngurtësohet. Në varësi nga përbërja dhe mënyra e përpunimit ekzistojnë më shumë lloje të çimentos, por më së tepërmi përdoret i ashtuquajtimi **portland-çimento**. Sasia e çimentos së përdorur në raport me betonin e prodhuar shkon në masën rreth 12 %, 567 ton/vit.

Linja teknologjike e prodhimit të betonit, vihet në punë sa herë që ka kërkesa për betone të markave të ndryshme. Eksperienca e punës në shfrytëzimin e saj ka tregu se lina ka punuar mesatarisht gjatë 185 ditëve.

XIV. Aktivitete të tjera që mund të nevojiten për zbatimin e projektit, si: ndërtimi i kampeve apo rezidencave etj.

Zbatimi i projektit të ndërtimit të linjës së prodhimit të markave të ndryshme betoni ka përfunduar dhe, kjo linjë teknologjike është në shfrytëzim prej disa vitesh. Kjo linjë teknologjike punon në mënyrë të programuar dhe për rrjedhojë kërkon një numur të kufizuar punëtorësh, të cilët duhet të kenë njohuri të mjaftueshme pune, në shfrytëzimin e makinerive dhe pajisjeve të kësaj nyjeje.

Në zonën e Çekinit, prej shumë vitesh ka qënë në shfrytëzim uzina ushtarake e prodhimit të armëve kështu që, mund të gjenden lehtësisht punëtorë me njohuritë e duhura për të shfrytëzuar linjën teknologjike të prodhimit të betoneve.

Në të tilla kushte nuk është e nevojshme ndërtimi i kampeve apo rezidencave.

XV. Informacioni për lejet dhe liçencat e nevojshme për projektin, në përputhje me përcaktimet e bëra në legjislacionin në fuqi, si dhe institucionet kompetente për lejimin/licencimin e projektit.

Ligji nr.10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, VKM nr 538 datë 26.05.2009 “Për licensat dhe lejet nga apo nëpërmjet QKL dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta (I ndryshuar) nuk përcakton saktë përfshirjen e veprimtarisë së prodhimit të betonit.

Ne vlerësojmë se kjo veprimtari mund të kategorizohet duke ju referuar legjislacionit të mësipar

FUSHA VIII INDUSTRI DHE SHËRBIME TË TJERA **KATEGORIA VIII.1** PRODHIMI, DEPOZITIMI, TRANSPORTI, PËRDORIMI DHE/OSE TREGETIMI I PRODUKTEVE DHE/OSE LENDEVE A PAJISJEVE TË TJERA ME RREZIKSHMËRI 1. Veprimtaritë e “Prodhimit, depozitimit, transportit, përdorimit dhe/ose tregtimit të produkteve dhe/ose lëndëve a pajisjeve të tjera me rrezikshmëri” bëjnë pjesë **në kategorinë VIII.1** e shtojcës së ligjit nr.10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”